

UDHËZIM
Nr. 13, datë 2.8.2012

PËR KRITERET BAZË NË MBIKËQYRJEN E SIGURISË SË MENAXHIMIT
TË TRAFIKUT AJROR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 78 pika 4 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve themelore dhe rregullave standarde për mbikëqyrjen e sigurisë së menaxhimit të trafikut nga Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës dhe zbatimin e tyre nga ofruesit e SHNA.

2. Zbatueshmëria

2.1 Autoriteti përgjegjës për zbatimin e procedurës së mbikëqyrjes së sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror është Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, si organi i ngarkuar me funksionet e Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës (AKM).

2.2 AAC mbikëqyr dhe garanton zbatimin me përpikëri të kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, nga Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror.

2.3 Kriteret bazë të këtij udhëzimi zbatohen nga strukturat e caktuara të aviacionit civil, ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror dhe nga i gjithë personeli i Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA), përgjegjës për detyrat të cilat janë përcaktuar të lidhura ngushtë me sigurinë.

3. Kërkesat e sigurisë

3.1 Autoriteti i Aviacionit Civil garanton, nëpërmjet procedurave teknike dhe inspektimeve përkatëse, që organizmat dhe personeli përgjegjës që mbulon fushën e shërbimeve të trafikut ajror, të lidhur ngushtë me sigurinë e trafikut ajror, ka zbatuar detyrat siç janë të përcaktuara në këtë udhëzim.

3.2 Përgjegjësitë e AAC

AAC, është përgjegjëse për:

a) mbikëqyrjen e përshtatshme dhe të mjaftueshme të rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, duke monitoruar në mënyrë sistematike dhe duke vlerësuar nivelin e sigurisë të arritur kundrejt niveleve standarde të përcaktuara;

b) kryerjen e veprimeve rregulluese përkatëse në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe me dispozitat e tjera ligjore për OSHNA;

c) AAC mbi bazën e rezultateve të monitorimit të sigurisë përcakton fushat ku është i nevojshëm verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat e rregullores së sigurisë.

3.2 Përgjegjësitë e OSHNA

Një OSHNA garanton:

a) zbatimin e detyrave që i lindin në bazë të përcaktimeve të këtij udhëzimi;

b) që në lidhje me procedurat që do të dalin për zbatimin e këtij udhëzimi, të dhënat që ekzistojnë, janë dokumentuar nga OSHNA dhe vihen në dispozicion, me kërkesë të AAC-së;

c) që nga pikëpamja e sigurisë, metodat përkatëse të zgjedhura janë ato që duhen, për të garantuar plotësimin e dispozitave të zbatueshme të këtij udhëzimi.

4. Procedurat e mbikëqyrjes

4.1 Autoriteti i Aviacionit Civil është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe nxjerrjen e procedurave përkatëse teknike për zbatimin e këtij udhëzimi.

4.2 Procedurat teknike duhet të jenë funksionale, ku të jenë përcaktuar qartë aspektet e planifikimit, implementimit dhe standardet e ofrimit të shërbimeve navigacionale ajrore nga OSHNA, si përgjegjësi kryesore për sigurinë në shërbimet e navigimit ajror.

5. Përfundime

AAC bën vlerësimin dhe garanton zyrtarisht një nivel ekuivalent sigurie në rastin e ekzistencës së rrethanave që bëjnë të pamundur zbatimin e kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në procedurat teknike përkatëse.

6. Shfuqizime

Udhëzimi nr. 4, datë 27.3.2009 “Mbi procedurat për mbikëqyrjen e sigurisë në ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi